



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë; Tel-Fax: 0693067738

E-mail: rmuca@klsb.org.al; Web-site: www.klsb.org.al

Nr. 46/5.Prot.

Tiranë, më30/06/2016

V E N D I M

Nr.75, Datë30/06/2016

PËR

EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
“MBROJTJA E KONSUMATORËVE NGA ABUZIMET TREGTARE ME
PESHËN DHE MATJET”

Në zbatim të planit vjetor 2016, Kontrolli i Lartë i Shtetit, në kuadër të përmbushjes së funksionit të tij Kushtetues, zbatimit të Udhëzimeve dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI, EUROSAI etj.), sipas shkresës nr. 46/1, datë 25.03.2016, Program Auditimi, ndërmori auditimin me temë “Mbrotjtja e konsumatorëve nga abuzimet tregtare me peshën dhe matjet”.

Ky auditimi u programua për t’u ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë (DPM) për periudhën e aktivitetit 2011 –2015. DPM është institucion publik buxhetor në varësi të ministrit përgjegjës për ekonominë, që drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili emërohet nga Kryeministri me propozim të ministrit për ekonominë. DPM, sipas organikës duhet të ketë 120 punonjës gjithsej, të shpërndarë në pesë drejtori, si Drejtoria e Metrologjisë Shkencore dhe Industriale, Drejtoria e Metrologjisë Ligjore, Drejtoria Inspektimit Metrologjik etj. DPM zhvillon aktivitetin e saj bazuar në ligjin nr. 9875, datë 14.02.2008 “Për metrologjinë” të ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij. DPM është përgjegjëse për metrologjinë shkencore dhe industriale, metrologjinë ligjore dhe inspektimin metrologjik. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, DPM ka për detyrë të ruajë dhe përdorë etalonet kombëtare të njësive të matjeve; të mbrojë konsumatorët nëpërmjet organizimit të kontrollit të instrumenteve matës në fushat e transaksioneve zyrtare dhe tregtare; mbrojtjen e shëndetit, mjedisit dhe sigurisë teknike, si dhe kontrollin sasior të parapaketimeve; të ofrojë shërbime të kalibrimit prodhuesve dhe përdoruesve të mjeteve matëse për të qenë konkurrues në tregun e brendshëm dhe të jashtëm.

Një ndikim të konsiderueshëm në jetën publike (private dhe zyrtare) kanë saktësitë e matjeve, ose treguesit e instrumenteve matës, rezultatet e të cilëve, në se nuk kontrollohen dhe monitorohen në vijimësi, shkaktojnë jo pak probleme pikësëpari ekonomike dhe financiare, por edhe shëndetësore e sociale. Në këtë mënyrë është shumë e rëndësishme që konsumatorët të njohin (dinë) atë çfarë janë duke marrë, dhe pikërisht për t’i mbrojtur nga abuzime të tilla, është ngritur dhe shërben Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë.

Gjatë aktiviteteve të jetës së përditshme, si individ apo organizatë publike dhe private, përballemi me çështje të lidhura ngushtë me metrologjinë, pasi matjet janë një pjesë mjaft e rëndësishme dhe zënë një vend të gjerë të veprimtarisë humane. Kështu, ushqimet e përditshme blihen në bazë të peshës, konsumi i energjisë elektrike dhe ujit faturohen në bazë të matjeve, furnizimi i automjeteve me karburant bëhet në bazë të vëllimit, koha përdoret në pagesat e telefonisë celulare, monitorimi i shpejtësisë së automjeteve për një udhëtim të sigurt, niveli i shkarkimeve të gazrave nga automjetet, kryerja e kontroleve mjekësore që të sigurohet shëndeti (nga pajisje me funksion të matshëm) etj. Vitet e fundit kanë marrë një përhapje të gjerë tregtimi i produkteve ushqimore të parapaketuara, së bashku me rritjen e shpejtë të numrit të supermarketeve, i cili kërkon një kontroll më të thelluar dhe me shtrirje më të gjerë. Në se i referohemi vëllimeve të tregtisë në botë, vlerësohet se afërsisht 90 % e saj është e matshme. Pra, nëpërmjet matjeve jo vetëm garantojnë tregje të hapura dhe të ndershme, sigurohet saktësi aty ku kërkohet, por dhe kursehen jetë, para dhe kohë.

Kërkesa bazë për të gjitha llojet e instrumenteve matës rrjedh nga standardi ligjor, i cili përcakton DPM-në për certifikimin, verifikimin periodik dhe kontrollin e instrumenteve matës, për shmangien e abuzimeve në këtë fushë. Edhe zbatimi i Direktivës së Instrumenteve Matës i BE-s ka përcaktuar si objektiv kryesor të kësaj politike lehtësimin dhe rritjen e tregut të tyre për arsye të interesit publik, shëndetit publik, sigurisë publike, rendit publik, mbrojtjes së mjedisit, mbrojtjes së konsumatorëve, mbledhjes së tatimeve dhe taksave etj. Komisioni Evropian në progres-raportin e vitit 2015, ka evidentuar se, nuk janë bërë përparime në përafrimin me këtë Direktivë. Sipas të dhënave statistikore, në vendet e zhvilluara pasaktësia në matjet e tregtisë me pakicë ndryshojnë nga 0,3 – 3 %, ndërsa në vendet e tjera ku ka një sistem të metrologjie të mangët, këto pasaktësi variojnë nga më pak se 1 % në mbi 20 %.

Me qëllim që abuzimet me matjet të jenë sa më të vogla për të mos rënduar jetën ekonomike dhe sociale të qytetarëve, kërkohet ngritja dhe funksionimi i strukturave përkatëse brenda DPM-së me burime njerëzore profesionale, të trajnuara, të testuara dhe të afta; me asete bashkëkohore që i përgjigjen zhvillimeve ekonomike kombëtare dhe ndërkombëtare; si dhe me një kuadër rregullator të plotë dhe të harmonizuar mirë për zbatim. Mangësitë e shfaqura në njërin ose në të tre këto drejtime kanë pasoja negative të ndjeshme tek konsumatori shqiptar, aq më tepër kur bëhet fjalë për një shtet me ekonomi informale mesatarisht 36 %, pra subjekte të palicencuara që përdorin instrumente matës jashtë kontrollit ligjor të DPM-së.

Në mënyrë të drejtpërdrejtë jetesa e qytetarëve ndikohet nga saktësia e matjes dhe peshave në shkëmbimet tregtare, nëpërmjet performancës së veprimtarisë të agjencive qeveritare të ngarkuara për verifikimin dhe inspektimin e subjekteve, si dhe zbatimit të detyrimit ligjor për kryerjen e verifikimeve periodike që paguhen nga vetë subjektet tregtare mbi bazën e numrit dhe të llojit të instrumentit matës në përdorim. Pra, këto agjenci ndikojnë edhe në grumbullimin e të ardhurave buxhetore dhe për pasojë aftësinë investuese publike nëpërmjet shpenzimeve qeveritare.

Gjithashtu, auditimi i jashtëm publik nëpërmjet KLSH, dhe për më tepër ai i performancës, është funksioni që lidh hallkat e ndryshme të aktiviteteve në institucione apo agjenci qeveritare, duke i orientuar ato drejt efektivitetit, eficiencës e ekonomicitetit dhe, në kuadër të këtij auditimi, nxitjen e përmirësimeve tërësore të nevojshme, në funksion të mbrojtjes së konsumatorëve shqiptar nga abuzimet me peshën dhe matjet.

Në përfundim të punës audituese në terren, iu dërgua Projekt-raporti i Auditimit subjektiv të audituar me shkresën nr. 46/2 prot., datë 14.06.2016. Pas respektimit të afatit për observacione nga palët e interesit, subjekti i audituar (DPM) me shkresën nr. 2914 prot., datë 23.06.2016, ka konfirmuar se pranon dhe është dakord me të gjitha gjetjet dhe konkluzionet e grupit të auditimit të KLSH-së, rekomandimet e të cilit janë prioritet për zbatim nga DPM në vijimësi.

Më pas, është hartuar në afatin ligjor Raporti përfundimtar i auditimit, në të cilin janë pasqyruar observacionet e DPM-së të ardhura me shkresën nr. 46/3 prot., datë 23.06.2016, duke konfirmuar gjetjet dhe konkluzionet e grupit të auditimit të KLSH, me zgjerim informacioni në raste të veçanta.

Në përfundim, pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projekt-vendimin e paraqitur nga grupi i auditimit të Departamentit të Auditimit të Performancës, shpjegimet e dhëna nga subjektet e audituara, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi dhe Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 15, shkronja “c” të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”:

K O N K L U D O V A:

Në kushtet që Shqipëria është e përqendruar në mbështetjen e rimëkëmbjes dhe rritjes ekonomike në një mjedis të jashtëm të vështirë, pjesë e sfidave kryesore mbetet menaxhimi me efektivitet i shpenzimeve publike, krahas konsolidimit fiskal, reformës rregullatore dhe institucionale, reduktimit të deficitit etj. Mbi këtë bazë qytetarët shqiptarë, si taksapagues dhe konsumatorë, janë të interesuar jo vetëm të marrin shërbimet e duhura në kohë, në cilësi dhe me kosto optimale nga institucionet administratës publike, por njëkohësisht të mbrohen me ligj interesat e tyre ekonomike.

Në këtë kuadër, shteti shqiptar ka krijuar institucione të posaçme për mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në treg. DPM në cilësinë e institucionit publik, nëpërmjet organizimit të kontrollit të instrumenteve matës në fushat e transaksioneve zyrtare dhe tregtare, krahas të tjerave ka për mision mbrojtjen e shëndetit, mjedisit dhe sigurisë teknike, si dhe kontrollin sasior të parapaketimeve; harmonizimi i procedurave dhe rregullave teknike të vlerësimit të matjeve me qëllim eliminimin e barrierave teknike për lëvizjen e lirë të mallrave, si dhe rritjen e cilësisë së jetës së qytetarëve shqiptarë.

Gjatë aktiviteteve të jetës së përditshme, si individ apo organizatë publike dhe private, përballemi me çështje të lidhura ngushtë me metrologjinë, pasi matjet janë një pjesë mjaft e rëndësishme dhe zënë një vend të gjerë të veprimtarisë humane. Kështu, ushqimet e përditshme blihen në bazë të peshës dhe parapaketimit, konsumi i energjisë elektrike dhe ujit faturohen në bazë të matjeve, furnizimi i automjeteve me karburant bëhet në bazë të vëllimit, koha përdoret në pagesat e telefonisë celulare, shpejtësia e automjeteve monitorohet për një udhëtim të sigurt, niveli i shkarkimeve të gazrave nga automjetet, shëndeti gjatë kontrolleve mjekësore sigurohet edhe nga pajisjet me funksion të matshëm) etj. Është më se e kuptueshme që në rastet e treguesve të deformuar të matjeve, pasojat tek konsumatorët janë ekonomike, financiare, sociale, shëndetësore etj. Duke ditur që në vitin 2014 në buxhetin familjar vetëm grupi “Ushqime dhe pije jo-alkoolike” zë 44,3 % të shpenzimeve, si dhe bazuar në vlerësimet se afërsisht 90 % e vëllimit të tregtisë në botë është e matshme, sigurimi i saktësisë së matjeve mbetet një element i rëndësishëm me ndikim në jetën ekonomike dhe sociale të qytetarëve, si dhe garantohen tregje të hapura me lëvizjen e lirë të mallrave.

Në këtë auditim performance, është synuar evidentimi i problematikave që lidhen me veprimtarinë e DPM-së, nëpërmjet analizës dhe vlerësimit, në se është duke vepruar ky institucion në mënyrën e duhur dhe duke bërë gjërat e duhura në kohë dhe me kosto optimale për të mbrojtur konsumatorin shqiptar nga abuzimet me peshën dhe matjet. Në këtë mënyrë, është bërë e mundur të evidentohen prirjet e ndryshme dhe të jepen rekomandimet përkatëse për përmirësimin e këtij shërbimi me ndikim të rëndësishëm në jetën ekonomike dhe sociale të

qytetarëve shqiptar.

Gjatë kryerjes së këtij auditimi, jemi përpjekur t'i japim përgjigje pyetjes: A siguron veprimtaria e DPM mbrojtjen e konsumatorëve nga abuzimet me peshën dhe matjet?, dhe në përfundim ka arritur në këtë mesazh auditimi:

Mbrojtja e konsumatorëve shqiptar nga abuzimet me peshën dhe matjen nuk është në nivelin e kërkuar bashkëkohor, pasi performanca e DPM-së ka shfaqur mangësi për shkak të kuadrit rregullator të papërpunur plotësisht me direktivat e BE-së dhe të pa harmonizuar mirë me aktet e tjera ligjore e nënligjore; nga menaxhimi joefektiv dhe joefektiv i burimeve njerëzore; nga mospërfshirja në verifikimin e instrumenteve matës të fushave me rëndësi jetike për popullsinë si atë të shëndetësisë, mjedisit, komunikimit telefonik, sigurisë publike etj; nga mungesa e bashkëpunimit me institucionet e tjera publike për përfshirjen në verifikim të të gjithë subjekteve me instrument matës në përdorim; nga problematikat e licencimit, monitorimit dhe inspektimit të personave të autorizuar në fushën e matëseve të energjisë elektrike dhe të ujit; nga veprimtaria inspektuese jo e qëndrueshme; si dhe nga mangësitë e konstatuara në fushën e kryerjes së investimeve dhe përdorimit të aseteve.

Nisur nga konkluzionet mësipërme të veprimtarisë audituese, duke synuar përmirësimin e mëtejshëm të rezultateve në këtë sektor:

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit të Performancës “Mbrojtja e konsumatorëve nga abuzimet tregtare me peshën dhe matjet”, të ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë (DPM).

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave për sa vijon:

I. Për pyetjen: A ka qenë efektive performanca e burimeve njerëzore dhe administrimi tyre?

- Struktura organike e DPM nuk ka një shpërndarje të drejtë të specialistëve në sektorët e DMSHI dhe DSCP, pasi një pjesë e tyre kanë në numër të konsiderueshëm nëpunësish, kanë të njëjtat detyra brenda sektorit dhe pothuajse nuk kanë demonstruar aktivitet me nivelin e pagës që janë shpërblyer, duke shfaqur mungesë efieience, me ndikim në mbrojtjen e konsumatorëve nga abuzimet me matjen dhe peshën.

Për këtë rekomandojmë

- 1. DPM të hartojë dhe nëpërmjet METTS të kërkojë miratimin e një strukturë të re organizative, duke siguruar përmbushjen e detyrave ligjore me një numër më të vogël sektorësh në DMSHI e DSCP, dhe duke rritur numrin e metrologëve në sektorët e shërbimit, e shoqëruar kjo dhe me ndryshimet e nevojshme në Rregulloren e brendshme.***

Brenda vitit 2016 për vitin e ardhshëm

- DPM për afër 4 vjet nuk ka krijuar një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, të bazuar në meritë, integritet moral dhe paanësi politike pasi, marrëdhëniet e punësimit kanë qenë të bazuara në Kodin e punës, duke ulur nivelin e mbrojtjes së punëmarrësit prej largimeve nga puna pa shkaqe ligjore, duke ndikuar negativisht në performancën dhe administrimin e

burimeve njerëzore dhe për pasojë dhe në cilësinë e verifikimit dhe inspektimit të instrumenteve matës.

- Në fund të vitit 2015 rezulton se në DPM janë 8 vende pune të paplotësuar për një periudhë kohore përgjithësisht rreth 2 vjet, megjithëse janë zhvilluar procedura konkurrimi nga ana e DAP, më e ndjeshme kjo në veprimtarinë verifikuese pasi mungojnë 3 metrologë të autorizuar (5 % e numrit gjithsej).

- Drejtoret e përgjithshëm të DPM nuk kanë miratuar kritere për punësimin e punonjësve në përputhje me vendet e punës, duke vepruar në kundërshtim me Rregulloren e brendshme të DPM-së së paku deri në tetor të vitit 2014, pas të cilit i janë nënshtruar procedurave të rekrutimit të nëpunësit në shërbimin civil.

- Metrologët e autorizuar në DPM nuk janë sipas kërkesave ligjore lidhur me profesionin dhe eksperiencën në punë, pasi në fund të vitit 2015, rezultojnë të jenë inxhinierë dhe matematicienë e kimistë vetëm 16 prej tyre ose 30 % që plotësojnë këto kërkesa.

- Në inspektorët metrologë vetëm 1 është me profesionin inxhinier elektrik dhe në pjesën më të madhe prej 60 % janë me profesionin e juristit (5) dhe atë të ekonomistit (4), por që nuk mungojnë dhe me shkollë profesionale shkenca politike, histori/gjeografi, teknologji bujqësore etj.

Për këtë rekomandojmë

2. DPM të marrë masat e nevojshme që nëpërmjet DAP-it të plotësojë vendet e punës me specialistët të profilit, duke vendosur kriteret përkatëse sipas kërkesave ligjore, me përparësi plotësimin e metrologëve të autorizuar, e lidhur kjo me veprimtarinë verifikuese të instrumenteve matës në terren.

Brenda tremujor i të tretë 2016

- Performanca e burimeve njerëzore është ulur edhe si rezultat i lëvizjeve të shpeshta të nivelit të lartë drejtues dhe për pasojë dhe atij manaxhues, pasi gjatë periudhës së auditimit 2011-2015 janë ndërruar 4 drejtorë të përgjithshëm me kohëzgjatje nga disa muaj deri në mbi dy vjet, si dhe në vitin 2013 është përfshirë në largim pothuajse i gjithë stafi i DPM: 123 persona (pasi ka pasur largime dhe emërimet për të njëjtët persona brenda vitit), nga të cilët vetëm 21 ose 17 % janë dorëhequr.

- Në kuadër të lëvizjeve të shpeshta brenda DPM-së, si dhe largimeve nga puna, nuk janë respektuar procedurat e dorëzimit të dokumenteve të punës, për shkak se titullarët nuk kanë marrë masa shtrënguese financiare ndaj tyre, duke sjellë si pasojë mungesë të theksuar të dhënash mbi ecurinë e veprimtarisë së drejtorive apo sektorëve të veçantë brenda tyre.

- Në periudhën e audituar 2011-2015 janë paguar nga buxheti i shtetit 64,578,923 lekë për largimet e paligjshme nga puna që kanë kryer titullarët e DPM-së në vite, vlerë kjo e përafërsisht e barabartë me investimet e këtij institucioni në dy vitet 2014-2015 të marra së bashku.

Për këtë rekomandojmë

3. Drejtori i përgjithshëm i DPM, pasi të sigurojë përputhje të plotë të kërkesave ligjore të stafit dhe specialistëve përkatës sipas vendeve të punës, të shmangë plotësisht largimet nga puna pa shkaqe të arsyeshme, si dhe të sigurojë qëndrueshmëri dhe transmetueshmëri të njohurive të stafit brenda institucionit, me qëllim që të rritet performanca e nëpunësve publikë.

Vazhdimisht

- Metrologët e autorizuar nuk janë testuar nëpërmjet provimit të kualifikimit për njohuri të mjaftueshme në fushën e metrologjisë ligjore, duke vepruar kështu në kundërshtim me Urdhrin

e Ministrisë të METE nr. 192, datë 09.03.2008, si dhe nuk ka pasur trajnime për metrologët dhe inspektorët, aq më tepër në kushtet e ndryshimeve të shpeshta të tyre.

Për këtë rekomandojmë

- 4. DPM të marrë masat e nevojshme për trajnimin e metrologëve të autorizuar për të siguruar njohuri të mjaftueshme në fushën e metrologjisë ligjore dhe më pas të kryejë testimin e tyre, me qëllim që të rritet performanca dhe të mbrohet konsumatori nga peshat dhe matjet e pasakta.**

Brenda vitit 2016

- DPM, me përjashtim të vitit 2015 (kur janë përfshirë në statusin e nëpunësit civil) nuk ka kryer vlerësimin në punë të punonjësve, dhe për pasojë nuk janë marrë masa disiplinore dhe/ose administrative për performancën e punonjësve, me gjithë problematikën e konstatuar gjatë periudhës së audituar.

Për këtë rekomandojmë

- 5. DPM të kryejë vlerësimin e punës së stafit dhe specialistëve gjatë dhe në fund të vitit, në përputhje me VKM nr. 109, datë 26.2.2014 “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë” si dhe VKM nr. 1037, datë 16.12.2015 “Për procedurat e vlerësimit të nëpunësve civilë, për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë”, duke marrë masat.**

Menjëherë dhe vazhdimisht

- Dokumentet e krijuara nga DPM, gjatë ushtrimit të funksionit administrativ, nuk janë të evidentuara, të regjistruara, të inventarizuara dhe të sistemuara, me qëllim që të ruhen, shërbehen dhe vihen në shfrytëzim, në funksion të njohjes me veprimtarinë e administratës shtetërore, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

Për këtë rekomandojmë

- 6. DPM të krijoj një grup të posaçëm pune për të sistemuar arkivën sipas viteve dhe drejtorive, komunikimin me arkivën e shtetit për të arkivuar një pjesë të dokumentacionit, si dhe të sigurojë një vijimësi në arkivimin e rregull të dokumentacionit të veprimtarisë administrative.**

Brenda vitit 2016

II. Për pyetjen: A është zbatuar kuadri rregullator në aktivitetin e metrologjisë ligjore?

- Kuadri rregullator mbi të cilin bazohet veprimtaria e DPM-së në përgjithësi, dhe DML-së në veçanti si një nga tre shtyllat kryesore të sistemit metrologjik, nuk është përfaruar sipas direktivave të BE-së dhe rekomandimeve të OIML-së dhe WELMC-ut.

- Nuk është bërë përafrimi i plotë, i përditësuar dhe i duhur, i Direktivës Evropiane për instrumentat matës, në kuadrin ligjor për metrologjinë, në funksion të rritjes së numrin e instrumentave matës ligjorisht të kontrolluar, si dhe përmirësimit të procedurave dhe teknikave të verifikimit të instrumenteve matës.

Për këtë rekomandojmë:

- 7. DPM-ja të hartojë dhe të kërkojë nga MZHETS miratimin e ndryshimeve në ligjin për metrologjinë, për ta harmonizuar atë me legjislacionin evropian në lidhje me kuadrin rregullator përkatës, duke synuar zgjerimin e fushave të mbrojtjes së konsumatorit shqiptar nga abuzimet me peshën dhe matjet.**

Brenda 6 mujorit të parë 2017

- 8. DPM-ja të hartojë, implementojë dhe të zbatojë teknikat dhe procedurat e aktiviteteve metrologjike sipas përcaktimeve dhe rekomandimeve të BE-së,**

WELMEC-ut dhe OIML-së, si dhe kur është e përcaktuar ndryshe të propozojë çështjet për miratim.

Menjëherë dhe vazhdimisht

- Nuk ka funksionuar Këshilli Metrologjik, duke ndikuar negativisht në përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të BE-së, përditësimin dhe përmirësimin e strategjisë së metrologjisë, krijimin e një rrejtë funksional të zhvillimit metrologjik në mbarë vendin, koordinimin e veprimtarisë së DPM-së me atë të ministrive dhe institucioneve të tjera shkencore në vendin tonë, zhvillimin e metodologjive, teknikave dhe procedurave të verifikimeve dhe kalibrimeve sipas përparimeve dhe zhvillimeve të shkencës në fushën e metrologjisë etj.

Për këtë rekomandojmë:

9. DPM-ja të marrë masa për funksionim e Këshillit të Metrologjisë, në kuadër të zhvillimit të sistemit të metrologjisë, duke përafruar kuadrin rregullator me atë evropian, përmirësimin dhe përditësimin e strategjisë së metrologjisë, rritjen e bashkëpunimit të DPM-së me strukturat e tjera shtetërore të vendit tonë si dhe zhvillimin lidhur me metodikat dhe procedurat metrologjike, sipas standardeve ndërkombëtare dhe praktikave më të mira.

Menjëherë dhe vazhdimisht

- Nuk janë përfshirë dhe rrjedhimisht mbuluar nga verifikimi metrologjik fusha kryesore ku përdorimi i instrumentave ka ndikim të konsiderueshëm dhe të vlerësuara me risk nga BE dhe organizatat ndërkombëtare të metrologjisë në mbrojtjen e konsumatorit si: në aparatat mjekësore, ato për vlerësimet e ndotjes së mjedisit, sigurinë publike, kohët bisedore etj.

Për këtë rekomandojmë:

10. DPM-ja të kërkojë nga MZHETS që të përfshijë në aktet nënligjore në zbatim të ligjit për metrologjinë, mbulimin me kontroll dhe verifikim metrologjik të instrumentave matës që përdoren në fushat e kujdesit shëndetësor, mbrojtës së mjedisit, sigurisë publike dhe tarifimit të kohë-matjes bisedore.

Brenda vitit 2016 dhe në vijimësi

- Shtimi i instrumenteve matës në kuadrin ligjor për metrologjinë nuk është pasuar me aktet dhe/ose rregulloret e nevojshme, sipas përcaktimeve dhe procedurave të miratuara ndërkombëtarisht për këto instrumenta, si p.sh. rasti i matësve të energjisë elektrike dhe ujit, analizuesve të alkoolit në frymënxjerrje për drejtuesit e automjeteve, radarëve matës të shpejtësisë, ku kanë munguar sipas rasteve përcaktimi i karakteristikave tekniko-metrologjike apo afatet për verifikimet periodike si dhe procedurat e sakta për kryerjen e verifikimeve.

Për këtë rekomandojmë:

11. DPM-ja të kërkojë nga MZHETS nxjerrjen e akteve nënligjore dhe rregulloreve përkatëse, duke u bazuar në direktivat dhe/ose rekomandimet e procedurat e BE-së, WELMEC-ut dhe OIML-së, ku të përfshihen karakteristikat metrologjike, afatet dhe procedurat për verifikimin, që duhet të pasojnë shtimin e kategorive të instrumenteve matës ligjorisht të kontrolluar.

Brenda vitit 2016 dhe në vijimësi

- Ka mangësi në harmonizimin dhe bashkërendimin e kuadrit legjislativ lidhur me importimin e instrumenteve matës, pasi mungojnë procedurat e identifikimit, regjistrimit dhe verifikimit të instrumentave matës të importuar, që në fazën e parë të hyrjes së tyre në doganë, duke sjellë si pasojë një treg të pakontrolluar, si dhe duke ndikuar negativisht në mbrojtjen e konsumatorit nga rreziku i kryerjes së shërbimeve me përdorimin e instrumenteve jashtë karakteristikave tekniko-metrologjike.

Për këtë rekomandojmë:

12. DPM-ja të kërkojë nga MZHETS përcaktimin në legjislacioni për metrologjinë dhe/ose nxjerrjen e akteve administrative në lidhje me bashkëpunimin me doganat, për përcaktimin dhe rregullimin ligjor apo administrativ, të identifikimit, të regjistrimit dhe verifikimit të instrumenteve matës të importuar që në fazën e parë të futjes në doganat shqiptare.

Vazhdimisht

- Nuk është përditësuar, harmonizuar dhe bashkërenduar kuadri rregullator brenda tij dhe me ndryshimet e rekomandimet sipas direktivës së BE-së e procedurave përkatëse, si dhe nuk është plotësuar me aktet e nevojshme nënligjore të miratimit dhe monitorimit të sistemeve të parapaketimeve, duke rrezikuar mbrojtjen e konsumatorit në lidhje me këto produkte.

Për këtë rekomandojmë:

13. DPM-ja të kërkojë nga MZHETS përditësimin, harmonizimin dhe bashkërendimin e kuadrit rregullator në lidhje me parapaketimet, duke saktësuar procedurat për miratimin dhe monitorimin e sistemeve të parapaketimeve dhe produkteve të tyre

Brenda vitit 2016 dhe vazhdimisht

- Mbajtja e saktë e regjistrave për instrumentat matës, mbledhja dhe grumbullimi i këtyre të dhënave nuk ka rezultuar efektiv, në kuadër të krijimit të një regjistri kombëtar të digjitalizuar, ku të jenë të identifikuar të gjithë instrumentet matës në përdorim në tregun shqiptar. Nga 2014 e më pas ka filluar regjistrimi elektronik në DPM në lidhje me instrumentet e verifikuar sipas dokumentacionit të dërguar nga sektorët e shërbimeve.

Për këtë rekomandojmë:

14. DPM-ja të marrë masa për evidentimin, saktësimin, dhe çregjistrimin e instrumenteve matës në përdorim në vendin tonë, duke krijuar database-in kombëtar për këtë qëllim, në funksion të rritjes së efektivitetit të veprimtarisë metrologjike ligjore dhe për pasojë mbrojtjen e konsumatorëve.

Vazhdimisht

III. Për pyetjen: A ka ndikuar veprimtaria verifikuese e DPM në mbrojtjen e konsumatorit shqiptar?

- Nuk ka qenë në nivelin e duhur performanca e veprimtarisë së metrologjisë ligjore të DPM-së, pasi për periudhën 2011-2015, ka pasur një mbulim të kufizuar të fushave dhe instrumenteve të verifikuar periodikisht, si rrjedhojë konsumatori shqiptar nuk është mbrojtur nga abuzimet me peshën dhe matjet në të gjitha aktivitetet e shërbimit e ofruara ndaj tij.

- Nuk është realizuar numri i verifikimeve të instrumenteve matës dhe subjekteve sipas planifikimit për një periudhë 3-vjeçare 2011-2013, duke reflektuar jo vetëm një nivel të dobët të efikasitetit të veprimtarisë së DPM-së për këtë periudhë, por dhe me pasoja për konsumatorin nga përdorimi i instrumenteve jashtë afateve ligjore për verifikim.

Për këtë rekomandojmë:

15. DPM-ja të marrë në analizë periodikisht duke evidentuar përgjegjësitë në veprimtarinë e sektorëve të shërbimit dhe të metrologëve brenda tyre dhe ta dokumentojë atë, në kuadër të vlerësimit të performancës së punonjësve të saj dhe garantimit të saktësisë së konsumatorëve në transaksionet tregtare.

Çdo muaj

- Rritja e numrit të verifikimeve në periudhën 2014-2015 nuk është shoqëruar me rritjen e numrit të subjekteve si gjatë fazës së planifikimit ashtu edhe të realizimit, çka do të thotë se ka pasur subjekte me instrumente matës të paverifikuar. Gjithashtu, rezultatet e veprimtarisë verifikuese nuk ndjekin trendin e numrit të subjekteve të regjistruara dhe të reja në institucionet e tjera zyrtare si INSTAT, QKR, DPT etj. Sipas këtij arsytimi, p.sh. në vitin 2014, vetëm numri i bizneseve të reja që ushtrojnë aktivitetin në vendin tonë ka qenë 16,731 nga 11,951 një vit më parë, pra me një rritje në rreth 40%. Ose në vitin 2015 që përbën numrin më të lartë të subjekteve të verifikuara nga sektorët e shërbimit të DPM në 22,795 subjekte, në një kohë kur kanë zhvilluar aktivitetin ekonomik 124,508 njësi lokale në të gjithë vendin, e shoqëruar kjo edhe me nivelin e lartë të ekonomisë informale. Të gjitha këto shfaqin mangësitë e DPM-së, DML-së dhe Sektorëve të Shërbimit në lidhje me identifikimin, regjistrimin dhe verifikimin e subjekteve dhe instrumenteve matës në treg, si dhe mungesën e bashkëpunimit me QKR-në, DRT-ët dhe Njësitë e qeverisjes vendore në lidhje me identifikimin e subjekteve të reja në treg, me qëllim rritjen e verifikimeve të instrumenteve matës dhe subjekteve.

Për këtë rekomandojmë:

16. DPM-ja dhe DML-ja, dhe Sektorët e Shërbimit, të rrisin bashkëpunimin me Drejtoritë Rajonale të Tatimeve, QKR-në si dhe me Njësitë e qeverisjes vendore, për të identifikuar dhe kryer verifikimet metrologjike në subjektet e reja të hapura, që ushtrojnë aktivitet tregtar apo shërbimi për të përdorur instrumenta matës ligjërisht të kontrolluar, duke evidentuar dhe përditësuar regjistrat me instrumentet dhe subjektet e reja, të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre në vendin tonë.

Vazhdimisht

- Nga ana e DML-së dhe sektorëve të shërbimit në varësi të saj, nuk janë kryer verifikimet metrologjike për instrumentat matës si “Sistemi matës i forcës i makinave testuese një aksiale të materialeve”, “Radarët për matjen e shpejtësisë” dhe “Analizuesit e pranisë së alkoolit në frymënxjerrjen e drejtuesve të automjeteve (analizuesit e alkoolit)” edhe pse këta instrumenta janë të përfshirë në VKM-në për kërkesat teknike dhe metrologjike të instrumentave matës dhe aktet e tjera nënligjore. Pavarësisht faktit se ka pasur një mos harmonizim të kuadrit rregullator në lidhje me këta instrumenta, mos kryerja e verifikimeve periodike në lidhje me këto instrumenta ul shkallën e mbrojtjes së konsumatorit dhe për më tepër në rastet e radarëve matës të shpejtësisë dhe matësve të alkoolit cenon sigurinë e jetës së qytetarëve, dhe në anën tjetër përdorimi i tyre pa kryer verifikimin metrologjik mund të penalizojë padrejtësisht qytetarin shqiptar.

- Një fushë e rëndësishme që nuk ka gjetur mbulimin e duhur nga veprimtaria verifikuese ka qenë ajo e parapaketimeve, të cilët llogariten se përbëjnë më shumë se 75% të vlerës së përgjithshme të mallrave të tregtuara në të gjithë botën, me prirje në rritje. Megjithëse ky sektor është krijuar që prej shkurtit të 2012, veprimtarinë regjistruese të subjekteve e ka filluar vetëm për periudhën 2014 me 94 subjekte dhe në vijim me 49 të tilla. Të qenit një sektor i ri i tregtisë në përgjithësi dhe DPM në veçanti, nuk ka një ndarje të qartë të veprimtarisë së këtij sektori dhe metrologjisë ligjore e inspektimit, duke reflektuar një veprimtari jo efektive me ndikim negativ në mbrojtjen e konsumatorëve.

Për këtë rekomandojmë:

17. DPM-ja dhe Sektori i Parapaketimeve, të marrë masa për evidentimin, regjistrimin dhe verifikimin e subjekteve prodhuese të parapaketimeve që ushtrojnë aktivitetin e tyre në vendin tonë; të rrisë bashkëpunimin dhe koordinimin e kësaj veprimtarive me DML-në, e shoqëruar kjo ndryshimin e rregullores së brendshme për të saktësuar detyrat e tyre, duke synuar rritjen e

efiçencës dhe efektivitetit të veprimtarisë verifikuese dhe monitoruese të parapaketimeve, për mbrojtjen e konsumatorit.

Brenda vitit 2016

- Gjatë periudhës 2011-2015, nga ana e DPM-së dhe metrologëve të saj apo qoftë edhe sektorëve dhe drejtorive të tjera, nuk është kryer veprimtaria verifikuese e lojrave të fatit, duke e parë këtë si një proces një në mbrojtje të konsumatorit. Certifikimi dhe verifikimi i karakteristikave të makinës ku luan qytetari duhet të ishte parë me fokusin në mbrojtjen e këtij të fundit, pasi janë institucionet publike ato që garantojnë dhe mbrojnë konsumatorin nga abuzimet që janë derivat i përdorimit të instrumentave matës jashtë karakteristikave tekniko-metrologjike.

Për këtë rekomandojmë:

18. DPM-ja, të kërkojë nga MZHETS që në bashkëpunim me MF-në dhe NJMLF-në si njësi varësie e saj, saktësimin e procedurave dhe koordinim të veprimtarisë ndërmjet institucioneve, në lidhje me verifikimin periodik të makinave në përdorim nga subjektet e lojërave të fatit, me qëllim mbrojtjen e qytetarëve dhe interesave shtetërore nga abuzimet me to.

Brenda vitit 2016

IV. Për pyetjen: A ka qenë efektiv aktiviteti i subjekteve të autorizuar për verifikimin e instrumenteve matës?

- Në periudhën 2011-2015 janë dhënë 9 autorizime subjekteve juridike për verifikim instrumente në tre fusha: në matësit e energjisë elektrike (2), matësit e ujit të pijshëm (4) dhe në cisternat rrugore automobilistike (3), nga të cilat dy të parat mjaft të rëndësishme për konsumatorin si nga ana e shpërndarjes territoriale në të gjithë vendin, numrit të përdoruesve, konsumit të përditshëm dhe të domosdoshëm, peshës së konsiderueshme në buxhetet familjare dhe të njërive ekonomike etj. Këto dhe rrethana të tjera, bëjnë që dhënia e autorizimeve për verifikimin e matësve të energjisë elektrike dhe të matësve të ujit të pijshëm, tarifat e tyre, si dhe numri i subjekteve juridike të autorizuar të jetë i një rëndësie të veçantë.

- Megjithëse audituesit e KLSH nuk audituan procedurën e pajisjes me autorizim të personave juridik për verifikimin e matësve të energjisë elektrike (pasi Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë ka filluar procedimin penal nr. 8854/2014, me nr. 14749 prot., datë 21.10.2015), duke marrë në shqyrtim dokumentacionin përkatës të periudhës konstatohet se janë shoqëruar me parregullsi si mosrespektim i afatit të shqyrtimit të kërkesës nga ana e DPM; dokumentacioni i paraqitur nuk është plotësuar sipas formatit ligjor; zona e juridiksionit është shënuar për gjithë Shqipërinë; në vizitat vlerësuese DPM ka pasur raste që nuk ka dërguar specialistë të fushës etj.

- DPM në vitin 2012 ka pajisur me autorizim në kundërshtim me ligjin një person juridik [REDACTED] për një fushë të cilën DPM ka mundësi t'i realizojë detyrat metrologjike, ato për verifikimin e distributorëve të karburantit dhe distributorëve të LPG, të cilën më pas e ka revokuar pas 9 ditësh (me datë 24.05.2012), duke vepruar me subjektivizëm të theksuar në verifikimin e periodik të instrumenteve matës.

Për këtë rekomandojmë:

19. DPM të zbatojë me rigozitetin kuadrin rregullator për pajisjen me autorizim të personave juridik dhe fizik për verifikimin e instrumenteve matës, duke respektuar afatet, ngritjen e komisioneve vlerësuese me specialistë përkatës, dokumentimin e gjithë kësaj veprimtarie dhe vlerësimin e raporteve përkatëse

për dhënien e autorizimit jo vetëm për transparencë të institucioneve publike, por si pikënisje për mbrojtjen e konsumatorëve nga abuzimet me matjet.

Vazhdimisht

- Ministri i METE ka nxjerrë Urdhrin nr. 436, datë 23.05.2012 për “Përcaktimin e numrit të subjekteve të autorizuar për kryerjen e shërbimeve në fushën e metrologjisë ligjore” ka urdhëruar DPM për autorizimin për verifikimin periodik të dy kompanive me zonat përkatëse të juridiksionit, si dhe për verifikimin fillestar ndarjen në mënyrë të barabartë të matësve të energjisë elektrike, duke vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9875, datë 14.02.2008 “Për metrologjinë” i ndryshuar pasi ka tejkaluar kompetencat e veta; ka shmangur konkurrencën në këtë fushë shërbimi metrologjik, duke rënduar koston e jetesës së konsumatorëve; duke përcaktuar zonat e shpërndarjes për secilën prej kompanive, ka marrë kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm të DPM; si dhe ka ndikuar veprimtarinë e DPM në dhënien e autorizimeve, duke krijuar dyshime të arsyeshme për veprime arbitrare të kësaj të fundit në dëm të interesave të biznesit, konsumatorëve dhe taksapaguesve.

Për këtë rekomandojmë:

20. Ministri i ZHETTS të shfuqizojë menjëherë Urdhrin nr. 436, datë 23.05.2012 për “Përcaktimin e numrit të subjekteve të autorizuar për kryerjen e shërbimeve në fushën e metrologjisë ligjore”, duke i hapur rrugë konkurrencës së lirë të kryerjes së shërbimeve metrologjike, dhe më pas DPM të kryejë ndarjen e zonave të juridiksionit sipas përcaktimeve ligjore.

Menjëherë

- Janë dy persona juridik () të cilët në periudha të ndryshme janë pajisur me autorizime nga DPM për verifikimin e matësve të energjisë elektrike dhe për verifikimin e matësve të ujit të pijshëm dhe industrial, duke përqendruar këtë treg të rëndësishëm dhe fitimprurës vetëm në dy subjekte dhe në dy fusha me ndikim të konsiderueshëm në mbrojtjen e konsumatorëve nga abuzimet me matjet dhe peshën.

Për këtë rekomandojmë:

21. DPM të marrë masa për të kontaktuar me organizata biznesi për të rritur interesimin e personave juridik dhe fizik vendas dhe të huaj që të përfshihen në shërbime të verifikimit të instrumenteve matës, për të cilët nuk mund t'i plotësojë këto detyra, duke bërë transparente veprimtarinë e tyre në fushën metrologjike.

Vazhdimisht

- Megjithëse janë nënshkruar me vonesë akt-marrëveshjet përkatëse me personat e autorizuar për detyrimet midis palëve, kryesisht për raportimin e regjistrimit të verifikimit të instrumenteve matës, nuk janë zbatuar deri në vitin 2014, duke bërë të pamundur njohjen e veprimtarisë së tyre nga ana e DPM.

- DPM nuk ka kryer kontrole vlerësuese (supervizuese) sipas përcaktimeve në Urdhrin nr. 194, datë 09.03.2009 jo më rrallë se një herë në 6 muaj deri në fillim vitin 2014, duke rrezikuar që personat e autorizuar të degradojnë nga ana e karakteristikave etalonëve dhe nga ana profesionale, si dhe me pasoja në cenimin e sigurisë së konsumatorëve për saktësinë e matjeve për energjinë e elektrike dhe ujin e pijshëm, dhe në të njëjtën kohë mungesë të ardhurash për DPM.

- Gjatë kontrolleve supervizuese periodike të kryera nga DPM në periudhën 2014-2015 janë konstatuar parregullsi nga ana e personave të autorizuar, të cilat në shumë raste kanë kërkuar shtyrjen e tyre, nuk kanë qenë të punësuar stafi i paraqitur në aplikimin për autorizim dhe ose

nuk janë njoftuar ndryshimet përkatëse, nuk kanë raportuar për aktivitetin e tyre, mospërdorimit të stendave të autorizuar etj.

- Drejtori i Përgjithshëm i DPM, në vitin 2014 nuk ka vepruar në përputhje me kuadrin rregullator përkatës për subjektin [REDAKTUAR] në dy raste për tërheqjen e autorizimit, pasi nga kontrollet vlerësuese periodike, ky subjekt ka rezultuar se ka degraduar për shkaqe objektive (etalonëve, kuadrin profesional), duke rrezikuar seriozisht mbrojtjen e konsumatorëve nga matja e pasaktë të energjisë elektrike.

Për këtë rekomandojmë:

22. Në kushtet e rritjes së kërkesave për të përfshirë sa më shumë fusha në verifikimin e instrumenteve matës dhe të shtimit të personave juridik dhe fizik të autorizuar, DPM të ngrejë një strukturë të posaçme me specialistë përkatës të fushës për ushtrimin e kontrolleve vlerësuese (supervizuese) periodike, si dhe Drejtori i Përgjithshëm të vlerësojë me transparencë dhe paanësi këto raporte, si dhe zbatojë kriteret ligjore, për të siguruar mbrojtjen e konsumatorit nga abuzimet me përdorimin e instrumenteve matës të parregullt.

Në tremujorin e parë të vitit 2017

- DPM nuk ka kontrolluar (inspektuar) herë pas here veprimtarinë e personave juridik dhe fizik të autorizuar, për pasojë nuk është në gjendje të japin përgjigje mbi cilësinë dhe saktësinë e matësve të energjisë elektrike dhe atyre të ujit të pijshëm, të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në mbrojtjen e konsumatorit nga abuzimet me matjet.

Për këtë rekomandojmë:

23. Inspektorati i Mbikëqyrjes së Tregut pranë MZHETTS, inspektorati përkatës metrologjik, të marrë masat e nevojshme për të përfshirë në veprimtarinë e vet kontrollin e personave juridik dhe fizik të autorizuar nga DPM në verifikimin e instrumenteve matës për të arritur në konkluzione mbi cilësinë e punës së tyre, duke ja paraqitur DPM për të vlerësuar degradimin e këtyre subjekte për shkaqe subjektive.

Menjëherë dhe në vijimësi

- Urdhri i ministrit të METE nr. 194, datë 9.03.2009 ka shfaqur mangësi gjatë zbatimit në praktikë në lidhje me miratimin e tarifave të verifikimit; mungesën e instrumenteve kontrollues të përputhjes së dokumentacionit të paraqitur në aplikim dhe atij të zbatuar në fakt; mungesën e procedurave për kontrollet periodike vlerësuese; rastet kur subjektit të autorizuar i tërhiqet autorizimi për një instrument, por që ka dhe verifikimin e instrumenteve të tjerë; paraqitja e të njëjtit personel nga i njëjti subjekt në kohët ndryshme ose nga subjekte të ndryshme dhe ndryshimi i tij krahasuar me atë në autorizim etj.

Për këtë rekomandojmë:

24. MZHETTS të rishikojë dhe në bashkëpunim të ngushtë me DPM, të hartojë një udhëzim të ri për praktikën e pajisjes me autorizim të personave juridik të detajuar, duke shmangur problematikën e evidentuar gjatë kësaj periudhe, me qëllim forcimin e vlerësimit dhe monitorimit nga ana DPM, në funksion të mbrojtjes së konsumatorëve nga abuzimet tregtare me matjet.

Brenda vitit 2016

V. Për pyetjen: Cila ka qenë performanca e inspektimeve për mbrojtjen e konsumatorëve nga abuzimet me matjet?

- Në periudhën e audituar baza ligjore e funksionimit të Inspektimit ka ndryshuar. Në periudhën nga viti 2011 - mars 2013, inspektimi ka qenë detyrë dhe e drejtë e DPM, që me 15

specialistët DIM të kontrollojnë zbatimin e dispozitave detyruese të ligjit dhe të rregulloreve të nxjerra në zbatim të tij. Pas kësaj date, duhej të funksiononte sipas VKM nr. 475, datë 10.04.2013 “Për inspektoratin shtetëror të mbikëqyrjes tregut”, i cili nuk u zbatua asnjëherë dhe u shfuqizuar në shtator të vitit 2013 me VKM nr. 870, datë 30.09.2013, si dhe veprimtaria e tyre duhej të kryhej në përputhje me ligjin nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Kjo mangësi e harmonizimit dhe bashkërendimit të kuadrit rregullator, ka bërë që inspektimi metrologjik në DPM për rreth 2 vjet e 9 muaj që të funksionojë jo në përputhje me bazën ligjore përkatëse. Mangësia në ngritjen e strukturave organizative në përputhje me ligjin (në rastin tonë të inspektimit metrologjik në varësi të Inspektoratit të Mbikëqyrjes së Tregut) e ka zbehur mjaft aktivitetin inspektues dhe për pasojë ndikimin e tij në mbrojtjen e konsumatorëve nga abuzimet me matjet dhe peshat.

Për këtë rekomandojmë:

25. DPM të bashkërendojë punën me MZHETTS për integrimin e inspektorëve metrologjik në Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, për të vënë në eficiencë të plotë kontrollin e saktësisë së instrumenteve matës dhe karakteristikave teknike e ligjore të tyre në të gjitha fushat, në funksion të mbrojtjes së konsumatorit nga abuzimet me matjet.

Menjëherë

- Me dështimin e kontratës së ndërtimit të rrjetit të IT-së në vitin 2011, me mungesën e dokumentacionit të dorëzuar gjatë ndërrimit të drejtuesve dhe inspektorëve, si dhe me një arkivë të pa sistemuar dhe inventarizuar, grupi i auditimit të KLSH, hasi vështirësi të shumta në kryerjen e analizave statistikore të dokumentacionit të grumbulluar, duke u kufizuar në analizat e të dhënave të viteve të fundit 2014-2015.

- Veprimtaria e inspektimit nuk ka pasur kritere dhe objektiva të qarta që në momentin e planifikimit të numrit vjetor të inspektimeve, pasi ato për tre vite radhazi janë në të njëjtën shifër dhe në dy vitet tjera ka luhate të konsiderueshme. Veç kësaj, niveli i realizimit të inspektimeve gjithsej është në kufirin midis nivelit më të ulët 59.2 % (viti 2015) dhe 77.2 % (në vitin 2012), me tendencë në rënie të vazhdueshme në vitet e fundit. Vlerësohet se kjo ka ndodhur për shkak të ndryshimit të bazës ligjore, lëvizjeve të konsiderueshme dhe të vazhdueshme të inspektorëve metrologë, mungesës së formimit profesional dhe eksperiencës në punë të tyre, përqendrimin e vëmendjes së DPM më shumë në realizimin e të ardhurave nga verifikimet e detyrueshme periodike të instrumenteve matës se sa tek cilësia kësaj veprimtarie etj.

- Në periudhën e audituar, peshën më të madhe të inspektimeve e zënë dyqanet fruta perime, bare etj., të cilat kanë instrumente peshore dhe masa vëllimore, duke të krijuar përshtypjen se inspektimet e kryera në këto subjekte janë bërë sa për të plotësuar numrin, në se këto nuk krahasohen me instrumentet matës të verifikuar nga metrologët ligjorë dhe me rezultatet e këtyre inspektimeve për të mbajtur në konsideratë riskun e instrumentit matës ligjorisht të kontrolluar. Duke krahasuar numrin e subjekteve të kontrolluara nga inspektorët me ato të verifikuara nga metrologët ligjorë rezulton se ka një rënie të konsiderueshme: nga 53.3 % në vitin 2011 në 18.8 % në vitin 2015, gjë që tregon për mungesë efieciencie dhe efektiviteti të veprimtarisë inspektuese.

- Bazuar në të dhënat tetor 2013-2015, rezulton se në pjesën më të madhe subjektet ose kanë instrumente matës të paverifikuar dhe/ose ka kaluar afati i verifikimit (në masën 71%), çka përbën një risk potencial të përdoruesve të tyre për të abuzuar në dëm të konsumatorëve, por që nuk mungojnë dhe rastet e moskonformiteteve në paketime etj.

Për këtë rekomandojmë:

26. Veprimtaria e inspektimit metrologjik të kryhet duke vendosur kritere dhe objektiva të qarta për planifikimin dhe realizimin me cilësi të numrit vjetor të inspektimeve, mbi bazën e riskut dhe instrumenteve të verifikuara nga metrologët ligjor, me prioritet fushat e aktivitetit me ndikim të ndjeshëm në jetën ekonomike dhe sociale të qytetarëve, në përputhje me ligjin për inspektimin dhe në zbatim të kërkesave rregullatore të metrologjisë.

Menjëherë dhe vazhdimisht

- Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nuk i janë nënshtruar aktivitetit inspektues personat juridik dhe fizik të autorizuar, veprimtaritë e të cilëve janë ligjërisht subjekt i inspektimit, duke lënë jashtë kontrollit dy fusha të përdorimit të instrumenteve matës me rëndësi jetike për qytetarët: atë të energjisë elektrike dhe të ujit të pijshëm e industrial.

- Duke analizuar numrin e inspektimeve sipas muajve në vitet 2014-2015, vërehen diferenca të konsiderueshme nga mbi 370 subjekte në afër 650, çka tregon për një performancë jo të qëndrueshme gjatë vitit, e karakterizuar si një veprimtari aksioni dhe sezonale, duke ndikuar në cilësinë e punës kontrolluese dhe për pasojë mangësi në mbrojtjen e konsumatorëve nga abuzimet tregtare me matjet.

- Sipas të dhënave të krahasuara për vitin 2015, rezulton se nuk mbulohet përafërsisht njëllor inspektimi i subjekteve me instrumente matës të verifikuar në të gjithë territorin e vendit, duke lënë të hapur mundësitë si për inspektime formale në disa zona dhe lënien jashtë të disa zonave të tjera, ashtu edhe për mungesë të monitorimit të veprimtarisë së metrologëve. Kështu p.sh. në Sektorin e shërbimeve nr. 1 Tiranë janë verifikuar 49.3% e subjekteve gjithsej në një kohë që inspektimi ka kryer 74.2 % të aktivitetit të tij, çka evidenton se një pjesë e tyre janë kryer afër sa për numër dhe disa zona të tjera si ajo e Korçës nuk është mbuluar siç duhet.

Për këtë rekomandojmë:

27. Inspektimi metrologjik të sigurojë një veprimtari kontrolluese gjithëvjetore me performancë të qëndrueshme dhe rezultative, si dhe mbulojë njëllor të gjithë territorin e vendit me inspektime, duke monitoruar njëkohësisht dhe punën e metrologut ligjor, me një ndikim të konsiderueshëm në saktësinë e matjeve dhe peshave në të gjitha aktivitetet jetësore të qytetarëve shqiptar.

Vazhdimisht

- Dokumentacioni i mbajtur nga inspektorët është shoqëruar nga parregullsi të tilla si: mangësi në plotësimin e dokumentacionit (Akt kontrolle, Procesverbaleve dhe Vendime gjobe), dorëzime me vonesë të vendimeve për gjobë etj. Ka raste që inspektorët kanë konstatuar raste të përdorimit të instrumenteve matës të pasaktë, të cilat japin sasi karburanti me vlerë poshtë tolerancës ligjore, kryesisht në periudhën 2011-tetor 2013, janë konsideruar thjeshtë dhe vetëm si kundërvajtje administrative, pa i dënuar me gjobë etj.

Për këtë rekomandojmë:

28. Inspektorët metrologë të trajnohem dhe të kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme për njohjen zbatimin me rigorozitet të kërkesave të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", si dhe të kryejnë analiza të thelluara të veprimtarisë së inspektorëve për të evidentuar përgjegjësitë dhe shmangur dyshimin e të vepruarit me dy standarde.

Menjëherë dhe vazhdimisht

- Konstatohet se 0.09-1.52 % e subjekteve janë gjobitur për shkak të parregullsive ligjore në përdorimin e instrumenteve matës, megjithëse numri i subjekteve është më i madh, kjo edhe nga mungesa e një përcaktimi të qartë ligjor në lidhje me rastet vendosjes së gjobave, në se ato duhet të shoqërojnë në çdo rast parregullsitë ligjore apo në varësi të vlerësimit të inspektorit,

subjektit përdorues t'i lihet afat për rivendosjen e situatës së instrumentit matës sipas kërkesave ligjore, duke kryer transaksione tregtare me instrumente matës jashtë kritereve teknike dhe ligjore, duke cenuar sigurinë e konsumatorit për saktësinë e këtyre këmbimeve.

- Numri i gjobave të vendosura ka ndryshime të theksuara nga viti në vit, tregon se penalizimi i subjekteve nuk ndjek prirjen e disiplinimit të përdorimit të rregullt të instrumenteve matës dhe në të njëjtën kohë mbrojtjen e konsumatorit nga abuzimet me matjet, pasi në vitin 2012 janë ndëshkuar vetëm 10 subjekte me gjobë, 130 në vitin 2013 e kështu me radhë. Veç kësaj, konstatohet se gjobat e vendosura nuk kanë një shpërndarje gjithëvjetore, por janë me fushata gjatë një periudhe të caktuar të vitit.

Për këtë rekomandojmë:

29. Inspektimi metrologjik të rrisë forcën ndëshkuese dhe penalizuese ndaj subjekteve që përdorin instrumente matës jashtë kritereve teknike dhe ligjore, duke rritur nivelin e sigurisë së konsumatorëve për saktësinë e këmbimeve tregtare.

Vazhdimisht

VI. Për pyetjen: A ka ndikuar në mbrojtjen e konsumatorëve penalizimi i subjekteve me instrumente matës të paligjshëm?

- Ndarja ligjore e ndëshkimit me gjobë fikse për subjekte të biznesit të madh dhe për subjekte të biznesit të vogël, ka krijuar një lloj konfuzioni në veprimtarinë inspektuese, pasi një vlerësim i tillë kërkon njohjen me dokumentacionin e tyre financiar në tatime, duke krijuar mundësinë e ndëshkimit jo sipas ligjit apo tejkallimit të tyre dhe për pasojë jo vetëm vonesa në ndëshkim për ulje të efektivitetit të kësaj mase parandaluese.

- Nuk ka pasur një procedurë të miratuar për dokumentacionin e gjobave nga ana e inspektorëve, pasi vërehet se edhe janë protokolluar, edhe janë dërguar me memo me dokumentacion bashkëlidhur tek titullari, edhe janë dërguar direkt tek sektori juridik, e cila mund të shkaktojë "humbje" të gjobave rrugës, duke shmangur ndëshkimin e subjekteve nga ekzekutimi i tyre.

Për këtë rekomandojmë:

30. DPM dhe MZHETTS të marrin masa për të ndryshuar ligjin për ndëshkimin e subjekteve në rastin e gjobës në vlera minimale dhe maksimale, të shoqëruar me një procedurë të veçantë për vendosjen proporcionale të tyre, duke hequr përcaktimin për llojin e biznesit, në funksion të eficiencës së plotë dhe në kohë të ligjit për metrologjinë.

Brenda vitit 2016

- Në periudhën 2012-2015 konstatohet se komisioni i ankimit nuk ka hequr asnjë prej gjobave të vendosura, duke konfirmuar në këtë rast dhe veprimtarinë e inspektorëve, pavarësisht ndryshimit të bazës ligjore. Ndërsa në vitin 2011 janë "falur" nga DPM 8.2 % e gjobave të pashoqëruara me asnjë masë disiplinore për inspektorët.

Për këtë rekomandojmë:

31. Gjatë shqyrtimit të ankimeve të subjekteve për gjobat e vendosura nga inspektorët, të kryhet një analizë e veçantë sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative, duke evidentuar mangësitë dhe përgjegjësitë e inspektorëve metrologë.

Vazhdimisht

- Janë ndëshkuar me gjobë një numër i vogël subjektesh, krahasuar me numrin e madh të inspektimeve dhe parregullsive të konstatuara: vetëm 0.65% e subjekteve; numri më i madh i

gjobave (130) është në 2013, si dhe numri më i vogël (10) është në vitin 2012, me prirje rënie nga 2013 e në vazhdim.

- Në strukturën e subjekteve të gjobitura gjatë kohës tetor 2013-dhjetor 2015 rezulton se 74 % e tyre ju përkasin njërive të tregtimit të karburanteve (në pjesën më të madhe të cilëve për shkaqe të furnizimit jashtë tolerancave ligjore), 15 % mungesës së peshës sipas etiketimit në subjektet e tregtimit të mallrave të parapaketuara, në vijim furrat e bukës, pikat e tregtimit të gazit etj. Nga këto të dhëna vërehet se konsumatori goditet pikërisht në ato lloje transaksionesh tregtare të nevojës së parë siç është buka, karburanti, gazi etj.

- Në analizën 2011-2015 rezulton se nga 92 raste të ankimuar në gjykatë, për 13 raste është hequr gjoba (14.1 %), për 24 % është lënë në fuqi vendimi i DPM dhe 54 çështje janë akoma në proces gjyqësor ose 58.7 % e tyre, 6 prej të cilave që në vitin 2011.

- Nga 270 gjobat e vendosura janë nxjerrë titujt ekzekutiv për 186 prej tyre (69 %) dhe rezultojnë të përmbushura plotësisht dhe/ose pjesërisht 91 prej tyre. Pra për këtë periudhë në çdo 3 gjoba të vendosura, DPM arrin të vjelë pjesërisht ose plotësisht vetëm një prej tyre brenda 5 vitesh. Pasi mjafton të cilësojmë, se nga gjobat e vendosura në vitin 2011 në vlerën 31,180,000 lekë janë arkëtuar brenda atij viti vetëm 3,770,000 lekë ose 12 % e tyre, për më tepër që këtë vit, subjektivisht nga juristi nuk është kërkuar në gjykatë nxjerrja e titullit ekzekutiv për 3 gjoba në shumën 2,250,000 lekë, që do të thotë që subjektet abuzuese janë parashkruar nga këto gjoba.

Për këtë rekomandojmë:

32. Inspektimi gjatë veprimtarisë së tij të rrisë forcën ndëshkuese me gjobë të subjekteve dhe të përmirësojë cilësinë e veprimtarisë së tij; të analizojë rastet e rrëzimit në gjykatë të masave ndëshkuese duke evidentuar përgjegjësitë; si dhe të zbatojë afatet optimale për të mbyllur plotësisht ciklin e gjobave, me qëllim maksimizimin e efektit ligjor në rritjen e sigurisë së konsumatorëve për saktësinë e masave dhe peshave.

Vazhdimisht

- Rezulton se gjobat nuk kontabilizohen në DPM, pas lëshimit nga gjykata të titullit ekzekutiv, duke lënë hapësira për “humbjen” e tyre dhe mosndëshkimin e subjekteve ose më së paku humbjen e efektit ndëshkues për subjektin e kundërligjshëm, kur kalojnë periudha të gjata kohe.

Për këtë rekomandojmë:

33. DPM të marrë masa për kontabilizimin e të gjitha gjobave në proces, nëpërmjet një procedure të mirëpërcaktuar dhe të bashkërenduar të sektorit juridik dhe atij të financës, si dhe të marrë në analizë në mënyrë periodike ecurinë e vendosjes dhe vjeljes së gjobave në të gjithë ciklin e tyre.

Brenda vitit 2016

VII. Për pyetjen: A janë kryer investimet sipas nevojave dhe kërkesave të një metrologjie bashkëkohore?

- DPM ka përfituar nga zbatimi i Projektit “IPA 2008” pajisje laboratorike në vlerën 310,423,961 lekë, nga të cilat rezulton se nuk janë vënë në punë dhe për pasojë nuk janë përdorur 25 % e shumës së financimit, ose 77,048,024 lekë).

- Nga zbatimi i Projektit me financime të huaja “Reforma në mjedisin e biznesit dhe forcimin institucional”, janë investuar 63,211,757 lekë, nga e cila nuk janë në funksion pajisje me vlerë 15,867,600 lekë ose 25 % e tyre.

Për këtë rekomandojmë:

34. DPM të bashkëpunojë me MZHETTS për të gjetur mundësi për vënien në funksion të pajisjeve të papërdorura, si dhe të marrë masa për investime për fusha të veçanta metrologjike që kanë ngelur zbuluar nga furnizime jashtë standardit.

Brenda vitit 2016

- Nga auditimi i investimeve të kryera në periudhën 2011 – 2015 me burim financimi buxhetin e shtetit rezulton se nga mangësitë e kryerjes së procedurave të prokurimit dhe mangësitë e zbatimit të kontratave të investimeve, nuk kanë dhënë asnjë lloj efekti në zhvillimin e metrologjisë 12,005,800 lekë ose së paku 8 % vëllimit të investimeve, pa marrë në konsideratë vlerat jo efektive të pamatshme gjatë procedurave të prokurimit si negocim i drejtpërdrejtë, kualifikim i subjekteve të papërshtatshme me kërkesat teknike dhe profesionale etj.

Për këtë rekomandojmë:

35. DMP-ja të marrë masa për kryerjen e procedurave të prokurimit për investime duke u bazuar dhe respektuar kuadrin rregullator përkatës, si dhe të zbatojë me korrektësi dhe përgjegjshmëri kontratat e mallrave dhe shërbimeve, me synim rritjen e efektivitetit të investimeve dhe mbrojtjen e konsumatorit nga abuzimet me peshën dhe matjet.

Vazhdimisht

- Në kuadër të mirëmbajtjes së aseteve, ndërtesa e aktuale e DPM me sipërfaqe 500 m² nuk është akoma në pronësi të saj; Qendra Rajonale Tiranë është zhvendosur në një apartament banimi me sipërfaqe 68 m², duke ndikuar ndjeshëm në performancën e veprimtarisë së këtyre specialistëve për mungesë të hapësirave të vendit të punës dhe ruajtjes dhe pajisjeve të nevojshme; Në sektorin e shërbimeve nr. 2 në Fier, përveç se është një ndërtesë që po amortizohet me ritme të shpejta për shkak të mungesës së investimeve për mirëmbajtje, është laborator masës me vlerë 3,606,157 i cili nuk përdoret dhe duke qenë në kushte të tilla, të gjitha pajisjet e punës humbin së shpejti karakteristikat teknike duke dalë jashtë përdorimit; zyrat e sektorit të shërbimeve nr. 3 në Lezhë rrezikojnë të dalin jashtë përdorimit për shkak të mungesës së fondeve për riparim dhe së bashku me këtë dhe pajisjet laboratorike me vlerë 6,966,960 lekë të cilat pothuajse nuk janë përdorur për qëllime metrologjike; autolaboratorët për parapaketimet në Lezhë dhe Korçë me vlerë 13,194,184 lekë nuk i shërbejnë atij qëllimi.

Për këtë rekomandojmë:

36. DPM të marrë masa për të vendosur në pronësi të saj ndërtesën kryesore, si dhe të evidentojë me prioritet nevojat për mirëmbajtjen e ambienteve të sektorëve të shërbimit, duke shmangur dhe parandaluar degradimin e mëtejshëm të këtyre aseteve dhe ruajtjen e karakteristikeve tekniko-metrologjike të pajisjeve laboratorike.

Brenda vitit 2016

VIII. Për pyetjen: A ka qenë në nivelin e kërkuar performanca e DPM për arkëtimin e të ardhurave nga kryerje e shërbimeve?

- Megjithëse plani i të ardhurave për shërbimet e kryera nga DPM është realizuar dhe tejkaluar, me prirje rritje të konsiderueshme në vitet 2014-2015, duhet mbajtur në konsideratë që të mos kthehet qëllim në vetvete për metrologët dhe punonjësit e tjerë, pasi jo vetëm që do të humbas roli i metrologut të autorizuar duke u kthyer në një “tagrambledhës” i vogël, por do të dëmtonte rëndë mbrojtjen e konsumatorit nga abuzimet me matjet.

- Nga analiza e periudhës së audituar 2011-2015, rezulton se ka mangësi të konsiderueshme në planifikimin vjetor të të ardhurave të bazuar në numrin e subjekteve dhe numrin e

instrumenteve matës për t'u verifikuar, pasi në periudhën 2011 - 2013 rritja e planit ka qenë 1 - 4 %, në 2014 është rritur 11 % dhe pastaj në 2015 vetëm 1%, aq më tepër i krahasuar me shifrat e realizimit të cilat në vitin 2014 dhe 2015 tejkalohen me 30 dhe 40 %, si dhe kjo ndodh me metrologë në pjesën më të madhe pa arsimin e duhur profesional, pa eksperiencën e nevojshme, të pa trajnuar, të pa testuar, me tre punonjës më pak etj. Nga analiza në dinamikë, mangësitë në planifikim vërehen në ndarjen e të ardhurave midis drejtorive, si dhe midis katër sektorëve të shërbimit.

- Rastet e mosrealizimit të numrit të instrumenteve të planifikuar nga sektorë dhe metrolog të veçantë evidentojnë problemin e mos verifikimit periodik në afat të instrumenteve me ndikim negativ të konsumatori, krahas të ardhurave të munguara në buxhet dhe në investime të DPM, si dhe në rastin e tejkalimit të numrit të instrumenteve të verifikuar krahasuar me planin, veç mangësive në planifikim shfaq boshllëqe të veprimtarisë së metrologut për një zonë apo instrument të caktuar. Vetëm në sektorin nr. 1 Tiranë, referuar të dhënave statistikore të DML, rezulton se në periudhën 2011-2014 nuk është realizuar verifikimi për 10,828 instrumente matës (aq sa është plani i numrit mesatar vjetor për gjithë DPM), më së paku nuk ka siguri për saktësinë e matjes dhe më së shumti janë të ardhura të munguar në buxhet mbi 26 milion lekë për këtë periudhë.

Për këtë rekomandojmë:

37. DPM të hartojë një plan real të ardhurash nga shërbimet e tarifuara me synim përfshirjen e të gjithë subjekteve dhe instrumenteve matës, mbi bazën e realizimit të një viti më parë si dhe të perspektivës së shtimit të subjekteve, të detajuar në muaj, sipas drejtorive, sektorëve rajonal deri në nivel metrologu.

Vazhdimisht

- Performanca në vjeljen e të ardhurave është rezultat i veprimtarisë individuale të metrologëve ligjor në sektorët e shërbimit, duke mbajtur në konsideratë dhe subjektet, numrin dhe shpërndarjen e instrumenteve matës midis tyre, pasi analizuar në tërësi dhe në dinamikë ka ndryshime të theksuara për këtë tregues brenda dhe midis sektorëve: metrologët e Korçës realizojnë 30 % më pak se ato të Tiranës dhe mesatarisht 88 % ato të Fierit dhe të Lezhës.

Për këtë rekomandojmë:

38. DPM të bëjë një analizë të hollësishme të veprimtarisë së secilit metrolog, mbi bazën e shtrirjes dhe numrit të subjekteve e instrumenteve matës të tyre, të krahasuar me të dhëna statistikore me synim hartimin e një plani të ardhurash sa më real, si dhe mundësinë e rishikimit të strukturës organike për rishpërndarjen e metrologëve në sektorët e shërbimit.

Brenda vitit 2016

- DPM nuk ka një database për emërtimin e subjekteve, aktivitetin, llojin dhe numrin e instrumenteve matës, adresën përkatëse etj.; nuk ka një studim të mirëfilltë për numrin e njësive private dhe publike që përdorin instrumente matës, si dhe llojet, kategoritë dhe numrin e instrumenteve matës gjithsej në përdorim; rritja e numrit të subjekteve me instrumentë për verifikim, duhet të pasqyrojë trendin rritës të numrit të subjekteve të reja të regjistruar në QKR apo të pasqyruar në shifrat e INSTAT, pasi sipas të dhënave të QKR në periudhën 2012-2014 janë regjistruar përkatësisht 26,025; 22,859 dhe 31,180 subjekte të reja, në një kohë që subjekte gjithsej të planifikuara për verifikim instrumenti nga DPM kanë qenë mesatarisht 21,600 njësi, pra as sa shtesa vjetore e tyre, që sigurisht jo të gjitha mund të kenë instrumente matës në përdorim; ose nga krahasimi i të dhënave të INSTAT për numrin e subjekteve aktive dhe të dhënave të DPM për subjektet e verifikuara në periudhën 2011-2014, rezulton se afërsisht 1/5 e tyre janë të përfshira në regjistrat e metrologëve.

Për këtë rekomandojmë:

39. DPM të marrë masa për të hartuar një database për subjektet dhe instrumentet matës të tyre të detajuar deri në nivel metrologu, si dhe të bashkëpunojë me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe QKR në funksion të mbrojtjes së konsumatorit nga abuzimet me matjet dhe shtimit të të ardhurave buxhetore.
Brenda gjashtëmuajorit të parë 2017

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Performancës.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R